



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 42, datë 03.05.2024

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti shitës	BASHKIA PRRENJAS
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP ☒ • Reklamim nga të tretë ☐
Numri i procedurave të verifikuara	1 (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë ankand publik "E hapur"
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Shitës nuk ka vepruar në përputhje me kreun II të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, lidhur me përlllogaritjen e vlerës fillestare të ankandit, në procedurën e ankandit objekt hetimi administrativ. 2. Autoriteti Shitës nuk ka vepruar në përputhje me nenin 40 të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar dhe kreun V të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, lidhur me hartimin e kriterëve dhe të dokumenteve të ankandit, në procedurën e ankandit objekt hetimi administrativ. 3. Autoriteti Shitës nuk ka vepruar në përputhje me nenin 36 të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar dhe kreun V të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e

	rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar, lidhur me vlerësimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, në procedurën e ankandit objekt hetimi administrativ.
Masat e marra	Në bazë të nenit 7, pika 2, gërmat “b” dhe “c”, të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar, APP vendosi t’i propozojë titullarit të Autoritetit Shitës marrjen e masës disiplinore, ndaj 5 personave, anëtarë të njësisë së ankandit, si dhe ndaj 2 personave, anëtarëve të komisionit të posaçëm për përlllogaritjen e vlerës fillestare të ankandit, të evidentuar përgjegjës, sipas konstatimeve në këtë vendim.